

PROÇES-VERBAL TIPI I KONTRATES-SHERBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirembajtje dhe riparim te mjeteve dhe automjeteve te Shoqerise”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
50110000-9-Sherbime dhe riparim te mjeteve dhe automjeteve te lidhuara,50112200-5-Sherbime Mirmbajte Makinash,50532300-6-Sherbime per riparimin dhe mirbajten e gjeneratoreve.

Loti 1 - “Mirembajtje dhe riparim i automjeteve” - 3,506,361 (tremilion e peseqind e gjashte mije e treqind e gjashtedhjetë e një)leke pa tvsh
shumatorja e çmimeve për njësi është : 1,965,761 (njemilion e nenteqind e gjashtedhjetë e pesemije e shtateqind e gjashtedhjetë e një) leke pa Tvsh

Loti 2 “Mirembajtje dhe riparim i mjeteve” - 3,478,109 (tre milione e katerqind e shtedhjetë e tete mije e njeqind e nente) leke ta Tvsh
shumatorja e çmimeve për njësi është : 1,342,910 (nje milione e treqind e dyzete e dy mije e nenteqind e dhjetë) leke pa Tvsh

Loti 3 “Mirembajtje dhe riparim i gjeneratoreve” - 615,502 (gjashteqind e pesedhjetë mije e peseqind e dy) leke ta Tvsh
shumatorja e çmimeve për njësi është : 337,902 (treqind e tridhjetë e shtate mije e nenteqind e dy) leke pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti kontraktor Ujesjelles Kanalizime Sh.A Sarande ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT(te njejta per Lot-in 1, “Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve” dhe Lot-in 2,”Mirembajtja dhe riparimi i mjeteve”)

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës I vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2024,2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% e fondit limit të Lot-it perkates,qe prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros mesatare, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet::

.... 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Kjo procedurë është nën kufirin ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare është jo më e vogël se 20% e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2024,2025,
Shenim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e ketij kriteri, ne menyre qe t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm në procedure.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të ligjit nr.25/2018 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të Lot -it perkates se kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori Ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin.
2. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori Ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse të shitjes të nënshkruara nga të dyja palët (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, që thote:

“ Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës..”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë sa 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Licenca profesionale si me poshte:

Kategoria: Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor

Nenkatëgoria: Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio

Kodi: VII.3.B.1

Lloji i kategorise: Licence, grupi 3

VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.B.1/b Riparimi dhe mirembajtja e karrocërave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.B.1/c Riparimi dhe mirembajtja e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.B.1/d Riparimi dhe mirembajtja e gomave, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

Argumentim: Kjo kerkese mbeshetet në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77,pika 1 a) , ne VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. neni 41, pika 4 a) dhe ne ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar dhe ne udhezimin Nr. 1546, datë 29.3.2016, te Ministrise se Transporteve dhe Infrastruktures.

2.3.3. Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për integrimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit,

Operatori ekonomik duhet te vertetoje nje punesim mesatar i te pakten tre punonjesish.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Në vendosjen e numrit të punonjësve është bërë një analizë bazuar te faktorët, si kualifikimi i punonjësve, zërat e punëve. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë jep siguri dhe besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën brenda afatit dhe me cilësi.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik, e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, gjithashtu, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te paktën tre persona, është në përputhje me volumin e punës dhe natyrën e punës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë fuqinë punëtore që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

- 2.3.4. Te kete ne sherbim dhe te deklaroje piken (at) e sherbimeve e riparimeve te mjeteve brenda territorit te bashkise Sarande, ku shtrin aktivitetin Ndermarrja e Ujesjelles Kanalizimeve Sarande,ose ne territorin e bashkive fqinje me bashkine Sarande, por me kusht qe, pika e servisit te mos jete me shume se 20 km larg nga qyteti i Sarandes

Argumentimi: Kjo kerkese mbeshtetet ne VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. nenit 41, pika 6), qe thote:

“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Me qellim qe automjeti i defektuar,te mos kryeje distanca te gjata(kur eshte e mundur te vetelevize),per te kryer sherbimin, dhe, ne rastet kur nuk mund te vetelevize,transporti i detyruar i tij, te mos kete kosto te larte dhe humbje kohe, eshte percaktuar distance prej 20 km, si nje distance e pershtatshme, per te perfshire ne kete procedure, edhe operatore ekonomike qe kane pika servisesh ne bashkite, Sarande, Konispol,Delvine e Finiq. Nje distance me e madhe se kjo, do te ishte e papershtatshme, sepse do te rriste ne menyre artificiale kostot e sherbimit dhe ne te njejten kohe do te kishim edhe humbje kohe te panevojshme

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT(Lot 3, “Mirembajtja dhe riparimi i gjeneratoreve”)

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentim.Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes I vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2024,2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% e fondit limit të Lot-it perkates, qe prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros mesatare, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë::

.... 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Kjo procedurë është nën kufirin ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1 dhe 2c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare është jo më e vogël se 20% e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve

financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2024,2025.

Shenim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme përfshirjen e këtij kriteri, në mënyrë që, t’i shërbejë atij, për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm në procedurë. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të ligjit nr.25/2018 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të Lot -it perkates se kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori Ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin.
2. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori Ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse të shitjes të nënshkruara nga të dyja palët (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.që thote:*

“ Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të

vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, nr nje vlere jo me te vogel se 20% të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Licenca profesionale si me poshte:

Kategoria: Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor

Nenkategoria: Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio

Kodi: VII.3.B.1

Lloji i kategorise: Licence, grupi 3

VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.B.1/c Riparimi dhe mirembajtja e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

***Argumentim:** Kjo kerkese mbeshetet në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77,pika 1 a) dhe ne VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. neni 41, pika 4 a) dhe ne ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar dhe ne udhezimin Nr. 1546, datë 29.3.2016, të Ministrise se Transporteve dhe Infrastruktures.*

Keto mjete ne fakt jane mjete stacionere,por punimet qe do te kryhen, jane te njejta me ato qe kryhen ne nje motor te nje mjeti rrugor, prandaj, jane kerkuar pikerisht keto dy pika te licensimit ne fushen e autoriparimit te mjeteve.

2.3.5. Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për integrimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit,

Operatori ekonomik duhet të vërtetojë një punësim mesatar i të paktën 2(dy) punonjësish.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Në vendosjen e numrit të punonjësve është bërë një analizë bazuar te faktorët, si kualifikimi i punonjësve, zërat e punëve, që sic percaktohet edhe në kategoritë e licensimit, janë dy kategori të ndryshme. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë jep siguri dhe besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën brenda afatit dhe me cilësi.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik, e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, gjithashtu, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 2(dy) persona, është në përputhje me volumin e punës dhe natyrën e punës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë fuqinë punëtore që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar nga një specialist fushe, inxhinier mekanik, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Nëpërmjet kësaj kontrate, synohet të realizohet mirëmbajtja dhe riparimi e automjeteve, mjeteve të renda dhe mjeteve stacionere, që shoqëria jone disponon.

Në specifikimet teknike është dhënë informacioni i nevojshëm për secilin mjet si; marka, tipi, viti i prodhimit, nr. shasisë, vendndodhja e mjeteve stacionere, llojet e lubrifikanteve për agregatat

speciale,raportin qe zene zerat e ndryshem te punimeve, etj, me qellim qe operatori ekonomik, te kete informacionin e duhur per te hartuar sa me sakte kontraten

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimsisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtje dhe riparim I mjeteve dhe automjeteve te shoqerise”